



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E PERGJITHSHME E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK
PER MINIERAT DHE INDUSTRIE
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE ✓

Nr...4280/2

Tirane, date 26/7/2015

Drejtuar: Z. JAMES NASO
SHOQERIA "JAB RESOURCES" SH.P.K
RRUGA "ILO MITKE QAFEZESI" VILA NR.12

TIRANE

Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z.RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.1701 date 23.05.2014.

I nderuar z. Naso,

Shoqëria "Jab Resources" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.1701 date 23.05.2014, për mineral bakri ne objektin "Iballe", Puke, Qarku Shkodër.

Keni bere kërkesë nr. 2015/00430 date 27.05.2015, për revokim te lejes minerare protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.4204 date 28.05.2015 te cilën ja keni drejtuar edhe Agjencisë Kombëtare te Burimeve Natyrore për dijeni, duke dhëne argumentet tuaja pse kërkon qe te revokohet leja qe ju keni ne zotërim.

Ne vazhdim te kësaj korrespondencë, pas plotësimit te dokumentacionit qe u është kërkuar nga struktura përgjegjëse AKBN, nga kjo struktura përgjegjëse me shkresën nr.6215/1 date 15.07.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.4280/1 date 16.07.2015, është propozuar revokimi i lejes nr.1701 date 23.05.2014, për mineral bakri ne objektin "Iballe", Puke, Qarku Shkodër, pasi nga verifikimet e bere ne terren rezulton se nuk është filluar aktiviteti minerar dhe zona minerare gëzon statusin e mëparshëm si para marrjes se lejes minerare ne fjale.

Ne shkresën qe cituam me sipër, drejtuar Ministrisë se Energjisë dhe Industrisë AKBN-ja thotë qe duke qene se subjekti, paraqet heqjen dore vullnetarisht e pa kushte për te drejtën minerare te fituar për shfrytëzimin e mineralit ne objektin "Iballe", Puke, propozojmë qe te behet çregjistrimi i lejes nr.1701 date 13.05.2014.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur në gjuhën “a” të pikës 2, të nenit 47, (neni që përcakton shkaqet ligjore për të cilat një leje revokohet) të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa me sipër në zbatim të pikës nr.1 të nenit 48 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1701 datë 23.05.2014, për mineral bakri në objektin “Iballe”, Puke, Qarku Shkodër.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1618 datë 02.04.2013.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

